



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:228284

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05705241

C.nr. 607/2023

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, përmes gjyqtares Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses H. K. nga, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shkelzen Feka, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e të ardhurave shtesë në bazë të licencimit, me vlerë të kontestit 852.93 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 20.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses H. K. nga, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim shkollor – fakultet, në lartësi 27 % të pagës bazë për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.01.2023, edhe atë për 13 muaj, shumën nga 55.35 euro për çdo muaj, e në shumë të përgjithshme prej **719.55 euro**, me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadiës për kompensimin e diferencës në pagë për kualifikim shkollor-fakultet, edhe atë për 13 muaj, shumën nga 10.26 euro për çdo muaj, këto në shumë prej 133.38 euro, REFUZOHET SI E PABAZUAR.

III. DETYROHET e paditura, që paditëses t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m i

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 24.10.2023, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e të ardhurave në bazë të licencimit, me vlerë prej te kontestit prej 852.93 euro. Në padi ka theksuar se e njëjta është e licencuar dhe ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim shkollor – fakultet, në lartësi 27

% të pagës bazë për periudhen nga data 01.01.2022 deri më datë 31.01.2023, edhe atë për 13 muaj, shumën nga 65.61 euro për çdo muaj, e në shumë të përgjithshme prej 852.93 euro. Baza ligjore lidhur me këtë kërkesë ka theksuar se gjendet në Kontratën Kolektive të Arsimit, neni 7, paragrafi 1, pika 1.3, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr. 01/33 të datës 29.08.2008, Udhëzimin Administrativ nr. 24/2014, nenin 21. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën t'ia kompensojë diferencën në pagë në bazë të kualifikimit për paditësin shumën e lartëcekur. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë 104.00 euro për përpilimin e padisë, 21.00 ne emër të taksës gjyqësore për padi.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditësit.

E paditura përmes përgjigjes në padi, ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke shtuar se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune të e paditura, mirëpo KKAK nuk është regjistruar në MPMS-së, ashtu siq kërkohet me Udhëzimin Administrativnr.12/2021, për regjistrimin e Marrëveshjeve Kolektive, nga ky fakt nuk prodhon efekt juridik, po ashtu ka theksuar se në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.5/2017, “licenca për mësimdhënësit lëshohet për një periudhë 5 vjeqare ndersa paditësi është me licencë të skaduar dhe të njejtit nuk kan zbatuar udhëzimin administrativ lidhur me vazhdimin e licencës. Më tutje ka theksuar se në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës, “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se padia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Gjykata, ka gjetur se mes palëve nuk janë kontestuese faktet se paditësi është i punësuar pranë të paditurës, as paga bazë apo kompensimet e shtesave, por kontestues është fakti se a ka bazë ligjore për kompensim të kualifikimit-licencimit shkollor për paditësin. Për gjykatën nuk është kontestuese se paditësi është mësimdhënës dhe i kualifikuar me fakultet dhe i licencuar (fakt i vërtetuar edhe nga Certifikata e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës nr.1285/a, e dt.14.04.2017, licenca e mësimdhënëses nr.100000706, i lëshuar nga MASHT); dhe se e njejta për kualifikim–Fakultet, është paguar në shumën prej 58.32 euro, ndërsa pagën e ka në shumë prej 421.00 euro, fakt i vërtetuar nga lista e pagës e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës).

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se

nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura.

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtave subjektive të paditësit dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe Kontratës kolektive në fuqi të datës 22.01.2021, konkretisht nenin 7 të kësaj Kontrate, si dhe Mendimit juridik me nr.prot.214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/33 i datës 29.08.2008, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritorë, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Po ashtu gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Në rastin konkret, gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me kualifikim- fakultet, pasi i njëjti është paguar në shumën prej 58.32 euro për kualifikim, ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhen për 27 % të pagës bazë, prej 421.00 euro, me ç’rast i ka mbetur borxh paditëses shumën prej 55.35 euro.

Nga kjo arsye, gjykata detyroi të paditurën t’ia kompensojë shumën e përcaktuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit të kualifikimit shkollor – përkatësisht diferencën e papaguar.

Nga të theksuarat më sipër, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses si në pikën dy të dispozitivit e refuzoi si të pa bazuar nga fakti se paditësja pagën bazë e ka në shumë prej 421.00 euro (sipas listës se pagave ne emër të paditëses), e që rrjedhimisht paditësja për muaj është paguar në shumë prej 58.32 euro, ndërsa sipas kualifikimit fakultet është dashtë të paguhet në lartësi prej 113.67 euro, respektivisht shuma prej 55.35 euro, nuk është paguar nga e paditura sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, prandaj gjykata kërkesëpadinë e paditëses e ka aprovuar pjesërisht duke e refuzuar si të pa bazuar, shumën prej 133.38 euro.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ashtu që ia njohi kërkesën e shpenzimeve sa i përket përpilimit të padisë dhe taksës gjyqësore, si shpenzime të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil
C.nr.607/23, më datë 20.05.2024

Gjyqtarja,
Valbonë Dërvodeli, d.v

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykatë.